

## E Folmja E Mallakastrës Në Ndarjen Dialektore Të Shqipes

Etilda Muhaj

Academy of Albanological Studies, Albania

### Abstract

Bazuar në të dhënat që ofrojnë studimet e deritanishme dialektologjike, nëpërmjet metodës krahasuese, përshkruese dhe analizës, në këtë artikull do të jepen argumentet që e vendosin të folmen e Mallakastrës në grupin e të folmeve perëndimore të nëndialektit të toskërishtes veriore dhe ato që e dallojnë atë si një të folme më vete.

Për këtë do të përdoren jo vetëm përfundimet e studimeve aktuale, por edhe shembuj konkretë që mbrojnë këto argumente, të mbledhura nga anketimet që kemi zhvilluar në terren.

**Keywords:** dhënat, mbledhura, anketimet

### 1. Introduction

E ndodhur midis Myzeqesë, Beratit dhe Labërisë, Mallakastra, si krahinë më vete, paraqet tipare të përbashkëta, por edhe të veçanta, që e dallojnë nga krahinat e tjera përreth nga pikëpamja dialektologjike.

Nisur nga karakteristikat e relievit të saj, banorët e ndajnë këtë krahinë në dy zona të emëruara "Mallakastër e Egër" (ose e Sipërme) dhe "Mallakastër e Butë" (ose e Poshtme). Në objektin tonë, nga pikëpamja gjuhësore duhet të përmendim se kjo lidhet me ndikimet që kanë të tiparet gjuhësore të secilës, fshatrat përreth.

Më poshtë do të përpiqemi të japim argumentet që ndihmojnë në përcaktimin e vendit të kësaj të folmeje në ndarjen e madhe dialektore të gjuhës shqipe, duke i përqasur tiparet e vërejtura me tiparet e grupit të të folmeve, të nëndialektit dhe dialektit përkatës.

Në çështjet pasardhëse do të paraqesim tiparet kryesore gjuhësore që kemi vërejtur gjatë anketimeve tona. Si referencë me të cilat do të krahasojmë të dhënat nga vëzhgimet tona, do të jenë studimet e mëparshme të cituara në fund.

### 2. Tipare gjuhësore në rrafshin fonetik sipas anketimeve

Në këtë syth do të rendisim karakteristikat që kemi vënë re gjatë vëzhgimit tonë për sa i përket nivelit fonetik të së folmes së Mallakastrës. I kemi grupuar ato dhe kemi dhënë shembuj për secilin grupim. Theksojmë se qëllimi, të paktën në këtë artikull, nuk është të japim vetëm tiparet e veçanta të kësaj të folmeje, por një panoramë pozicionimi ku herë shfaqen tipare që e bashkojnë me një grup të caktuar të folmesh, që tregojnë përkatësinë e saj në dialektin toskë, tipare të përbashkëta me të folme krahinash a fshatrash të veçanta (qoftë edhe të gegërishtes) e herë tipare që e dallojnë atë.

1. Ashtu si në shumicën e të folmeve të toskërishtes, edhe në të folmen e Mallakastrës vihet re shfaqja e 7 zanoreve të theksuara të shkurtra: /ã/ (*plak* dhe jo *pla:k*), /ẽ/ (*vesh* dhe jo *vesh*), /ĩ/ (*ditë*), /y/ (*byk*), /ũ/ (*lug-u*), /õ/ (një *lot*), /ẽ̃/ (ai *bën*). Ky tipar shfaqet në tërë të folmet e Myzeqesë, Labërisë, Devollit, Oparit, Skraparit, Kolonjës, Dangëllisë, Lunxhërisë, Zagorisë, Gorës, Vërçës, Mokrës etj. Kujtojmë këtu se variantet

hundore të theksuara të fonemave të mësipërme /ã/ (*bën*), /ẽ/ (*end*), /ĩ/ (*u mpi*), /ỹ/ (*sy*), /ũ/ (*hu-ri*), në të folmen e Mallakastrës dhe në krahinat e renditura më lart dhe në gjithë jugun e Shqipërisë (toskërishte) nuk ekzistojnë.

- Në të folmen e krahinës së Mallakastrës paraqet interes takimi i bashkëtingëlloreve /z/ e /n/ në kufi të morfemave, kur /z/-ja është në fund të temës dhe /n/-ja në fillim të mbaresës. Në Aranitas kemi /z/ + zanore + /n/ në emra dhe në folje (*orizin*, *ndezën*); Në Varibopë kemi /z/ + zanore + /n/ në emra (*orizin*) dhe vetëm /z/ në folje (*ndez*); Ky përdorim në Varibopë është i ngjashëm me krahinat Buzi i Madh, Muzhakë (Skrapar), Frashër (Përmet), Taçi i Madh (Ersekë) si dhe Mokër (Pogradec). Të folmet e tjera kanë përdorim të njëjtë me Aranitasin.
- Fonema /e/ e theksuar me variantet fonetike të pakushtëzuara të fonemave gjegjëse në përbërjen fonemore të fjalëve *e enjte*, *e premtë*, *emër*, *femër*, *thembër*, në të folmen e Mallakastrës krijon larmi, sepse në Varibopë ajo del /ə/ ndërsa në Aranitas ajo del /e/ dhe /ə/ e hapur. Këtë e shohim edhe në Luar (Fier), Buzi i Madh (Tepelenë), Frashër (Përmet).
- Në përbërjen fonemore të fjalëve *fre*, *pe*, në Aranitas kemi /ə/, ndërsa në Varibopë kemi edhe /e/ edhe /ə/. Këtë formë e ka vetëm Varibopë dhe asnjë krahinë tjetër.
- Një tipar i përbashkët i të folmes së Mallakastrës me të folmen e Mbrakullës së Beratit, Kaçanikut (Kosovë) dhe Nepravishtës së Gjirokastrës, është shfaqja e bashkëtingëllores /h/ në fillim dhe në mes të fjalës (*ha*, *krah*, *duhan*, *lahet*). Ky tipar e dallon atë nga të folmet e tjera të toskërishtes veriore ku ajo del vetëm në fillim të fjalës. Në përbërjen fonemore të fjalëve *leh*, *shoh*, *njoh*, *ndihmë*, *lahem*, në krahinën e Mallakastrës, ashtu si në gjithë gegërishten qendrore dhe lindore, Myzeqe, Berat, Korçë, Pogradec, dhe Skrapar, edhe këtu nuk ekziston. Dallim në Mallakastër për këtë fonemë ka vetëm për fjalën *leh* ku në Aranitas /h/-ja nuk ekziston.
- Edhe në Mallakastër ekziston fonema /r/ (rruaj) dhe kundërvënia e saj me fonemën /r/. Ky është tipar i thujse gjithë krahinave përveç Beratit, Delvinës, Vlorës, Korçë, Devoll, Dibër dhe Gollobordë.

7. Në këtë të folme, ashtu si në gjithë të folmet e shqipes, me pak përjashtime, bashkëtingëllorja /l/ (*vëlla, diell*) del paragjuhore, shtegore sonante anësore. Te përjashtimet përmendim të folmen e Gjirokastrës dhe Dajçit (Shkodër) ku kjo del paragjuhore, shtegore e zëshme. Ndërsa në krahinat Nepravishtë dhe Shkodër kjo bashkëtingëllore del si variant fakultativ.
8. Edhe në të folmen e Mallakastrës bashkëtingëllorja /th/ (*them-thuaj*) shfaqet paragjuhore shtegore e shurdhët. Tipar ky i përbashkët përveç krahinave Kus (Tiranë), Gojani i Epërm (Mirditë) dhe Elbasani.
9. Edhe në këtë të folme, bashkëtingëllorja /dh/ (*dhi*) del paragjuhore shtegore e zëshme. Përjashtim nga të tjerat në lidhje me këtë tipar bën Peçini (Elbasan), Pikali, Vermoshi, Tuzi, Vridhi (Malësi e Madhe) ku kjo bashkëtingëllore del prapagjuhore shtegore e zëshme (Elbasan) dhe paragjuhore shtegore e shurdhët ose e zëshme (fakultative).
10. Në këtë të folme fonemat bashkëtingëllore /ç/ dhe /xh/ (*çaj, viç, xhep, oxhak*) paraqiten /ç/ paragjuhore mbylltore e shurdhët dhe /xh/ paragjuhore mbylltore e zëshme. Sërish tipar i përbashkët i shqipes ky, ku përjashtim bëjnë krahinat e gegërishtes qendrore dhe verilindore (Kashnjet, Manati në Lezhë dhe Gojani i Epërm, Grykorosh në Mirditë, Lurë, Pukë, Kukës, Has) ku këto fonema paraqiten mesgjuhore shtegore të zëshme dhe të shurdhëta, si dhe mesgjuhore mbylltore të zëshme dhe të shurdhëta.
11. Po kështu fonemat bashkëtingëllore /q/ dhe /gj/ (*qafë, gjak*) në të folmen e krahinës së Mallakastrës dalin mesgjuhore mbylltore e zëshme /q/ dhe e shurdhët /gj/. Dallim në lidhje me këtë tipar shfaqin krahinat e gegërishtes qendrore dhe verilindore ku këto fonema dalin paragjuhore mbylltore e shurdhët dhe paragjuhore mbylltore e zëshme (Mat, Dibër, Kukës, Gollobordë).
12. Tipar që vihet re edhe në të folmen e Mallakastrës, është shfaqja e fonemës bashkëtingëllorë /nj/ (*njeri, i njomë, një*) si mesgjuhore shtegore sonante, ndërkohë që ajo nuk ekziston në krahinat Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Has, Rrafshi i Dukagjinit, Elbasan, Podujevë, Vuçiternë.
13. Tipar i përbashkët që tregon vendin e të folmes së Mallakastrës në toskërishte, është mosshfaqja e fonemës /ŋ/ si prapagjuhore shtegore sonante (ngushtë, kungull, trung, lëng). Tipar ky i gjithë toskërishtes, ndryshe nga gegërishtja ku kjo fonemë shfaqet si e tillë.
14. Në të folmen e Mallakastrës grupet e bashkëtingëlloreve /mj/ (mjekërr, mjaltë), /pl/ e /bl/ (plak, ble), /fl/ (fle), shfaqen po njësoj /mj/ /pl/ /bl/ dhe /fl/, gjë që ndodh në gjithë shqipen me përjashtim të të folmeve të zonave Gur-Lurë, Sohodoll, Lekbibaj, Iballë, Lalëz, Prezë, ku ato dalin /mnj/ /pj/ /bj/ dhe /fj/.
15. Tjetër tipar i përbashkët me të folmet e tjera të toskërishtes është që grupi i bashkëtingëlloreve /fsh/ tek emrat (*kofshë, lafshë, mëndafsh*) si dhe te format e dëshirores së foljeve që u mbaron tema me zanore (*punofsh, lafsh, shkofsh*), bëjnë /f/. Tipar ky që dallon në gegërishten veriperëndimore ku ky grup shfaqet /f/.
16. Tjetër tipar që tregon përkatësinë e të folmes sonë në toskërishte, është ekzistenca në të gjitha kushtet fonetike të grupeve të bashkëtingëlloreve /mb/ (*mbiell, kumbull, thumb*), /nd/ (*nder, këndoj, shkund*), /ng/ (*ngushtë, kungull, trung, cung*), /ngj/ (*ngjyey, ngjesh, ngjall*), /tj/ dhe /dj/ (*tjerr, i djathtë*). Përjashtim nga kjo bëjnë vetëm Progonati (Tepelenë) dhe Fterra (Sarandë) në jug dhe po ashtu gjithë të folmet e gegërishtes ku këto grupe nuk ekzistojnë në të gjitha kushtet fonetike.
17. Në të folmen e Mallakastrës fonema /u/ e patheksuar në rrokje të mbyllur nga bashkëtingëllorja /ll/ dhe /r/ kthehet nga e mbyllur në rrokje të hapur në trajtën e shquar, si në fjalët: *vetull- vetulla, hekur- hekuri* etj.
18. Tipar tjetër që vihet re është edhe ndërrimi i fonemave bashkëtingëllore të zëshme me ato të shurdhëtat kur ndodhen në pozicion fundor absolut (*elb, zog, brez, i madh*). Dallojnë këtu zonat e Tiranës, Pezës, Krumës dhe Petkajt në Kukës ku këto nuk ndërrohen. Ndryshe ndodh kur këto fonema gjenden në pozicionin fundor absolut te fjalët që kanë dalë në këto kushte fonetike pas rënies së zanores së patheksuar /ë/, që ka qenë në fund të fjalës. Në këto raste ato nuk ndërrohen me të shurdhëtat (*lugë, degë, i verdhë*).
19. Takimi i bashkëtingëlloreve /n/, /t/ dhe /k/ në kufi të morfemave, njëra në fund të temës dhe tjetra /n/-ja në fillim të mbaresës bën edhe në të folmen e Mallakastrës, ashtu si në gjithë shqipen /n/ + zanore + /n/: *duhanin*, /t/ + zanore + /n/: *detin*, /k/ + zanore + /n/: *mikun*. Bëjnë dallim disa krahina ku del /n/: *den*, si krahinat e toskërishtes lindore Këmbëthekër, Nikollarë, Korçë, Gjerbës (Skrapar) etj.
20. Fonema /i/e theksuar me variantet fonetike në përbërjen fonemore të fjalëve *lis, gj, i ri, brinjë, viç, fik- fiq*, dhe *shisja, vidhja, thikë, mish, ditë, bie* etj. në të folmen e Mallakastrës, ashtu si në të gjitha krahinat, veç gegërishtes jugore bën /i/.
21. Fonema /y/e theksuar me variantet fonetike në përbërjen fonemore të fjalëve *sy, yll, atyre, qymyr, dy, ky, gjysh, gjysmë* dhe *lyp* në të folmen tonë del *sy, yll, atyre, qymyr, dy, ky, gjysh* etj. Dallim për përdorimin e kësaj foneme bëjnë Gërmëni dhe Klosi në Mat, Kashnjeti dhe Manjati në Lezhë, ku del /i/.
22. Fonema /u/e theksuar me variantet fonetike në përbërjen fonemore të fjalëve ku nuk ndodhet pas bashkëtingëlloreve qiellzore /q/, /gj/ dhe /l/, /r/, por edhe kur nuk vjen pas këtyre bashkëtingëlloreve, në krahinën e Mallakastrës bën /u/ si në rastet: *pushkë, nuse, këput, mur, shumë, burr, rrush, hu, unë, qull, lugë, grua, arushë, grurë, grusht* etj.
23. Fonema /ë/ e patheksuar në përbërjen fonemore të fjalës kur gjendet në rrokje nistore të hapur që fillon me bashkëtingëlloren sonante /m/ te fjalët: *mëzat, mëshqerrë*, në këtë krahinë bën /u/: *muzat, mushqerra*, e ngjashme kjo me toskërishten jugore.
24. Fonema /ë/ e patheksuar në përbërjen fonemore të fjalëve ku gjendet në rrokje nistore të hapur pas një bashkëtingëlloreje të zhurmët në të gjitha krahinat e toskërishtes ekziston /ə/, si në fjalët: *gëzim, këpucë, përrua, të marr* etj.
25. Togu zanor /ua/ në krahinën e Myzeqesë, Vlorës, Mallakastrës dhe Beratit del shpesh /ua/ ose /ua°/ (me /a/ të labializuar si në fjalët: *duar, muaj, buall, grua, ftua, dua*).
26. Togu i zanoreve /ue/ në të folmen e Mallakastrës, në përbërjen e fjalëve *mësues, sulmues*, /u/-ja nuk ekziston.
27. Fonema /ë/ e patheksuar në përbërjen fonemore të fjalëve ku gjendet në rrokje mesore të hapur, pas një bashkëtingëlloreje të zhurmët, para theksit dhe para një bashkëtingëlloreje tjetër të zhurmët, në krahinën e Mallakastrës nuk ekziston /ə/, dhe kjo është e njëjtë me



asnjanëse.

### 3. Tiparet sintaksore

Të fundit ndër tiparet që e pozicionojnë të folmen e Mallakastrës te grupi perëndimor i të folmeve të nëndialektit të toskërishtes veriore do të paraqesim tiparet e rrafshit sintaksor, nga të cilat kemi veçuar të mëposhtmet.

1. Përshtatja e emrave ambigjenë që e formojnë shumësin me *-e*, dhe në disa raste të atyre që mbarojnë me *-ra*: *malet e larta, ato fshatrat e keqe, pusët e thella*.
- 2) Kur kryefjala është emër përmbledhës, kallëzuesi vihet rregullisht në numër shumës: *se m'than gjith shoqëria, gjysma e bëjn..., në qoftë se e prishin me luft Mallakastra*.
3. Në fjalitë e bashkërenditura, sidomos në ato me marrëdhënie kundërshtore, lidhja është përgjithësisht asindetike: *nji radhë i takon natën, nji radhë ditën; një, që kish forcat merte, një që skish, s'merte; ne kemi nat e dit aty, ju talli; ajo ësh lop tamëm, qy thot jo*.
4. Lidhja asindetike vihet re edhe te fjalitë e nënrenditura:
  - qëllimore: *u mundua atijen ai ta shikonte mbreti qysh i hante, ai do shkonj do fler;*
  - shkakore: *po çë do poplli e hëngri, kot që t'rrij ai, nashti pjeprat u mbaruan, moshe madhe ishnja, spunonja dot;*
  - kushtore: *do punonç, do marrç; do mirje njqint lek, do paguanje një e gjysëm etj.*

### Materials and methods

Rezultatet e këtij artikulli janë pjesë e një studimi më të gjerë në kuadër të studimeve doktorale. Të dhënat që do të sjellim janë mbledhur nga vrojtimit e bëra në terren, nëpërmjet anketimeve të orientuara me anë të pyetësorëve specifikë ("Pyetësorët e hartuar nga S. Floqi, Gj. Shkurtaç, M. Domi, dhe ai pjesë e atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe), por edhe nëpërmjet bisedës së lirë tematike.

Këto rezultate i kemi krahasuar me ato të nxjerra nga vjeljet e bëra nga Jorgji Gjinari, i pari që ka realizuar studime mbi të folmen e Mallakastrës.

Informatorët tanë u përkasin grupmoshës 60-85, për vetë faktin se brezat e vjetër ruajnë më mirë tiparet e të folmes, por kemi zgjedhur qëllimisht për efekt krahasimi edhe informatorë të grupmoshës 35-50 dhe asaj 14-18.

### 5. Conclusions

Nga përçasja e tipareve të nxjerra nga anketimet dhe analizat përkatëse, me tiparet e vërejtura në studimet paraardhëse kryesore të deritanishme mbi grupet e të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të shqipës, kemi provuar më sipër se e folmja e Mallakastrës bën pjesë në grupin perëndimor të të folmeve të nëndialektit të toskërishtes veriore. Nga gjithë materialet e vjela gjetëm tiparet e përbashkëta që e bëjnë pjesë të këtij nëndialekti, tiparet e përbashkëta që tregojnë përkatësinë e saj në grupin perëndimor të të folmeve të këtij nëndialekti dhe gjithashtu tiparet e veçanta që e dallojnë atë si të folme më vete.

### 6. References

1. Sadiku T. Mallakastra dhe Myzeqeja në rrjedhat e historisë deri në 1840, 2009.
2. Gjinari J, Beci B, Shkurtaç GJ. Xh. Gosturani. Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe. Napoli: Universita degli Studi di Napoli L'Orientale, 2007.
3. Gjinari J. Dialektet e gjuhës shqipe. Tiranë, 1989.

4. Gjinari J. Vërejtje për të folmen e Mallakastrës, në: Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, 1962, 148-180.